

prill  
2022

Kapacitetet e


vetëqeverisjeve

lokale në përmbushjen

e obligimeve në luftën

për mbrojtjen e mjedisit





**Titulli i hulumtimit:**

Kapacitetet e vetëqeverisjeve lokale në përmbushjen e obligimeve në luftën për mbrojtjen e mjedisit

**Botues:** KFOS

**Për botuesin:**

Komunikimi për zhvillimin e shoqërisë - CSD

**Autorët:**

Ivan Nikolić, Ivan Todorović

Gjuha origjinale në të cilën është shkruar analiza është gjuha serbe

**Përkthimi në gjuhën shqipe dhe angleze:**

Bruno Neziraj

**Dizajni:** *Innovation Media*

**Tirazhi:** 80

Ky publikim është hartuar në kuadër të projektit OPEN i cili implementohet nga Fondacioni i Kosovës për Shogëri të Hapur (KFOS) në bashkëpunim me Komunikimin për Zhvillimin e Shoqërisë (CSD). Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS-it.

Viti i botimit: Prill, 2022



# Përmbajtja

analizë

7 Rreth nismës OPEN

7 Përshkrimi i gjendjes dhe detektimi i problemit

9 Gjendja e mjedisit në komunat në jug të lumit Ibër me popullatë shumicë serbe

9 Ajri

9 Uji

9 Toka

10 Mbeturinat

10 Forcat shtytëse

10 Struktura/rjedhat demografike

11 Urbanizmi

11 Trafiku

12 Përdorimi i tokës dhe mbulueshmëria

12 Presionet (rreziqet) mbi mjedisin

12 Energjia

13 Industria

13 Transporti

14 Bujqësia

14 Pylltaria

15 Synimet e studimit dhe metodologjia

15 Synimet

16 Metodologjia

16 Metodologjia dhe struktura e mostrës kuantitative

16 Metodologjia dhe dizajni i hulumtimit kualitativ

19 Rezultatet e hulumtimit

31 Konkluzioni

33 Rekomandimet

35 Studim i rastit, lumi Graçanka



# Hyrje

## Rreth nismës OPEN

Hulumtimi u zbatua në kuadër të nismës OPEN. “Demokracia, hapja dhe perspektiva e komunitetit serb në Kosovë – Open” është një nismë e re e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), e filluar në vitin 2020. Open zbatohet në bashkëpunim me nëntë organizata të shoqërisë civile që veprojnë në komunitetin serb në Kosovë. Qëllimi i përgjithshëm i nismës së re është të zhvillojë një hapësirë të hapur dhe dinamike për diskutim brenda komunitetit serb, në mes të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera, si dhe institucioneve në Kosovë.

Nisma do të adresojë në mënyrë specifike analizën dhe vlerësimin e ndikimit të organizatave civile dhe politike mbi demokracinë dhe hapjen e komunitetit serb në Kosovë. Do të analizohen dhe vlerësohen demokracia dhe hapja e institucioneve, politikat publike dhe proceset e rëndësishme ndaj komunitetit serb në Kosovë, si dhe shkalla e hapjes së komunitetit serb ndaj tyre. Këto analiza do të ndihmojnë për të kuptuar gjendjen aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, përderisa në të njëjtën kohë do shërbejnë si bazë për përfaqësim argumentues ndaj qytetarëve, institucioneve të qeverisë lokale dhe qendrore si dhe bashkësisë ndërkombëtare. Organizatat me përvojë dhe të dëshmuara të shoqërisë civile, për të arritur qëllime të përgjithshme dhe specifike do të realizojnë tetë (8) analiza sektoriale.

## Përshkrimi i gjendjes dhe detektimi i problemit

Ndotja e ajrit, resurset e kufizuara ujore, kapacitetet e kufizuara të menaxhimit të mbeturinave, si dhe urbanizimi dhe ndërtimi i pakontrolluar krijojnë presione të mëdha ndaj mjedisit në Kosovë, duke rrezikuar kështu standardin e jetesës dhe shëndetin e njerëzve në Kosovë.

Sipas shumë hulumtimeve, Kosova është një nga zonat më të ndotura në Evropë<sup>1</sup>. Këto gjetje janë aktuale në vetëm 4-5 vitet e fundit, d.m.th. që nga vendosja e infrastrukturës që ka për qëllim kontrollimin e cilësisë së mjedisit në Kosovë. Një nga pikat më shqetësuese është se cilësia e ajrit në Kosovë, ashtu si në vendet fqinje, është jashtëzakonisht e keqe në periudhën e dimrit dhe vazhdimisht vendos rekorde negative të ndotjes së ajrit në nivel global. Termocentralet të cilat djegin qymyr si lëndë djegëse kryesore, minierat e linjtit, ngrohja e amvisërive me lëndë djegëse të ngurta dhe emetimet e automjeteve kontribuojnë më së shumti në cilësinë e keqe të ajrit.

Në këtë analizë kryesisht do të fokusohemi në cilësinë e mjedisit në komunat me shumicë serbe në Kosovë në jug të Ibrit, si dhe kapacitetin e këtyre komunave për tu përballur me presionet mjedisore.

Komunat me shumicë serbe në Kosovë janë formuar sipas planit të Marti Ahtisaarit dhe buxhetet e këtyre pushteteve lokale janë miratuar në bazë të numrit të banorëve në bazë të regjistrimit të vitit 2011. Duke pasur parasysh se komuniteti serb në Kosovë në atë

<sup>1</sup> <https://balkangreenenergynews.com/bih-north-macedonia-most-polluted-countries-in-europe-report/>

kohë pjesërisht kishte bojkotuar regjistrimin, buxhetet e pushtetit lokal me shumicë serbe u reduktuan ndjeshëm në krahasim me situatën reale në terren, dhe me këtë u zvogëlua kapaciteti i komunave për t'u përballur efektivisht me presionet mjedisore. Praktika në nivel global tregon se vendet në zhvillim dhe vendet e pazhvilluara investojnë shumë pak në mbrojtjen e mjedisit dhe se janë shumë të vogla fondet që do të ofronin hapësirë më të madhe për veprim të nismave mjedisore. Situata e njëjtë është edhe në Kosovë. Edhe pse ekziston një kornizë e gjerë ligjore dhe kuptim të problemit të ndotjes së mjedisit, shumë pak vëmendje i kushtohet mbrojtjes së mjedisit, si materialisht ashtu edhe në çdo kuptim sepse ligjet dhe dokumentet e miratuara shpesh janë tepër ambicioze dhe praktikisht joreale. Në komunat me shumicë serbe, situata është edhe më problematike, ku mungesa e demokracisë, nepotizmi dhe korrupsioni ndikojnë dukshëm në mungesën e vetëdijes për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit. Tendencat e tilla të realitetit socio-politik mbështeten në analizat e bëra nga Iniciativa Open në vitin 2020.<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> Miodrag Miki Marinković (Miodrag Miki Marinković), Raport i Konsoliduar Open 2020 - Karakteristikat e një shoqërie të hapur në komunitetin serb në Kosovë, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS, 2020.





# Gjendja e mjedisit në komunitat në jug të lumit Ibër me popullatë shumicë serbe

Gjendja e mjedisit përshkruan sasinë dhe cilësinë e dukurive fizike (p.sh. temperatura), dukurive biologjike (p.sh. rezervat e peshkut) dhe fenomeneve kimike (p.sh. përqendrimi i CO<sub>2</sub> në atmosferë) në një zonë të caktuar. Me treguesit e gjendjes mund të përshkruhen për shembull pyjet dhe fondi i kafshëve të egra të pranishme në pyll, përqendrimi i fosforit dhe squfurit në liqene dhe lumenj ose niveli i zhurmës në një lagje afër burimeve të zhurmës siç janë aeroportet. Gjendja e mjedisit ndryshon për shkak të presioneve të ushtruara ndaj mjedisit. Ndryshimet në gjendjen e mjedisit ndikojnë në pjesët përbërëse të mjedisit.

## Ajri

Ajri është një element shumë i rëndësishëm për shëndetin e njeriut dhe në përgjithësi për mjedisin që na rrethon. Ajri është vazhdimisht nën ndikimin e ndotjes nga burime të shumta. Edhe pse ndotja e ajrit vjen kryesisht nga aktivitetet njerëzore, mund të shkaktohet edhe nga fenomene natyrore.

Sipas Agjencisë së Mjedisit, ndotësit më të mëdhenj që ndikojnë në cilësinë e ajrit janë energjia, industria dhe trafiku. Meqenëse Graçanica nuk ka stacione matëse për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe pasi i përket rajonit të Prishtinës, që është vetëm 8 km larg, devijimi nga parametrat e matur në Prishtinë është minimal<sup>3</sup>. Përveç rreziqeve

dhe presioneve që ndikojnë në cilësinë e ajrit (energjia, industria, komunikacioni, mungesa e filtrave natyrorë-pyjeve), ndikim të madh në cilësinë e ajrit në Graçanicë ka edhe djerrina e hapur ku depozitohen mbeturinat nga miniera e Kishnicës. "Fenomeni" i reve të portokallta është një dukuri e zakonshme gjatë gjithë vitit. Erërat dhe rrymat e ajrit shpesh mbledhin mbetje që përmbajnë metale të rënda dhe komponime toksike që paraqesin një rrezik të madh për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

## Uji

Uji është një burim shumë i rëndësishëm si për zhvillimin ekonomik ashtu edhe për shëndetin publik. Megjithatë, flukset e zhvillimit të shoqërisë që manifestohen me shtimin e llojeve të ndryshme të aktiviteteve prodhuese: bujqësi intensive, zgjerim të vendbanimeve, urbanizim dhe aktivitete të tjera, jo vetëm që ndikojnë në shfrytëzimin e këtij resursi, por edhe në ndotjen, gjë që ka rezultuar të jetë një praktikë e keqe në këto komuna.

## Toka

Ndikimi i vazhdueshëm i aktiviteteve njerëzore kontribuon në degradimin e sipërfaqes së tokës, duke shkaktuar pasoja të dëmshme socio-ekonomike dhe mjedisore. Sfidë është parandalimi i degradimit dhe ndotjes së tokës me ndihmën e masave dhe politikave

<sup>3</sup> Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit

të caktuara për mbrojtjen e tokës. Në të gjitha komunat në të cilat kemi kryer hulumtimin nuk kemi konstatuar apo marrë vesh për ndonjë masë dhe politikë për mbrojtjen e tokës nga degradimi dhe ndotja.

## Mbeturinat

Mbeturinat krijohen gjatë aktiviteteve të përditshme. Zhvillimi i teknologjisë ka rezultuar në krijimin e llojeve të ndryshme të produkteve të paketimeve dhe ambalazheve, si dhe materialeve të tjera, ambalazhi ose paketimi i të cilave bëhet mbeturinë pas përdorimit. Prodhimi i mbeturinave komunale për kokë banori në Kosovë është në rritje. Sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare të Kosovës nuk është adekuate. Në Kosovë ende ka mbeturina të rrezikshme të trashëguara nga aktivitetet industriale dhe teknologjike (djerrina e hapur e minierës në Kishnicë).

## Forcat shtytëse

Forcat shtytëse - në aspektin e mbrojtjes së mjedisit përshkruajnë zhvillimet sociale, demografike dhe ekonomike në shoqëri, si dhe ndryshimet përkatëse në stilin e jetesës, nivelet e përgjithshme të konsumit dhe prodhimit. Forcat kryesore shtytëse janë rritja e popullsisë dhe zhvillimi i nevojave dhe aktiviteteve të saj. Në fakt, këto janë forcat kryesore që shkaktojnë ndryshime në nivelin e përgjithshëm të prodhimit dhe konsumit. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve në prodhim dhe konsum, forcat shtytëse ushtrojnë presion mbi mjedisin.

## Struktura/rjedhat demografike

Numri i banorëve - Sipas rezultateve të regjistrimit të vitit 2011, i cili pjesërisht u bojkotua nga serbët, në Komunën e Graçanicës janë regjistruar 10.675 banorë. Nga numri i lartpërmendur, 7209 janë serbë (67,53%), 2474 shqiptarë (23,18%), 745 romë (6,98%)

dhe 247 nacionalitete të tjera. Struktura fetare sipas këtij regjistrimi ishte si më poshtë: 7.237 ishin ortodoksë, 3.190 myslimanë dhe 42 katolikë.

Piramida e moshës - Nga numri i përgjithshëm i popullsisë në komunën e Graçanicës, 5.418 janë burra dhe 5.257 gra. Tek burrat, përqindja e personave nën 18 vjeç është 29,66%, me 1.607, ndërsa te gratë është 29,71%, me gjithsej 1.562 të regjistruara.

Organizata ndërkombëtare OSBE, bazuar në shërbimet komunale, vlerëson popullsinë e Graçanicës në 21.534, me një përqindje të serbëve prej rreth 85%.

Dendësia e popullsisë - Me rritjen e popullsisë së Kosovës, niveli i popullsisë mesatare për njësi të sipërfaqes së tokës është rritur nga 62.7 (1948) në 81 banorë/km<sup>2</sup> (2011).

Rritja e numrit të përgjithshëm të popullsisë ndikon në mjedis në shumë mënyra, ndër të cilat më kryesoret janë: ndikimi në nivelin e prodhimit, shfrytëzimi i resurseve, mënyra e përdorimit të tokës, si dhe gjenerimi i mbeturinave dhe ndotja e mjedisit.

Migrimet janë shumë të theksuara edhe në Komunën e Graçanicës. Një pjesë e popullsisë që vendoset në vendbanimin e Graçanicës emigron nga vendbanimet rurale përreth ose nga komunat ku serbët janë komunitet jo shumicë. Përveç komunitetit serb edhe ai shqiptar po gjen vend për të krijuar jetë në komunën e Graçanicës, gjë që ndiqet nga rritja e numrit të popullsisë. Kur bëhet fjalë për emigrimin e komuniteteve pakicë, më së shpeshti është popullata e re, e pafavorizuar ekonomikisht.

Sipas raportit të hulumtimit, migrimi i heshtur i të rinjve nga komuniteti serb, i publikuar në vitin 2019 nga OJQ-ja Komunikimi për Zhvillimin e Shoqërisë (CSD), dallohen disa nga përfundimet e mëposhtme:

OO Si arsye pse të anketuarit duan të largohen nga komuna, shumica dërrmuese

kanë përmendur gjendjen e keqe të sigurisë, situatën e keqe politike dhe ekonomike, dhe pak më pak se gjysma e të anketuarve kanë deklaruar se pamundësia për të gjetur punë është një nga motivet kryesore të emigrimit.

OO Tre të katërtat e të anketuarve planifikojnë të emigrojnë nga Kosova, ndërsa deri në dy të tretat planifikojnë ta bëjnë këtë përgjithmonë, ndërsa 20% tashmë kanë ndërmarrë hapa konkretë drejt emigrimit.

OO 30% e të anketuarve kanë deklaruar se nëse largohen, nuk duan të kthehen në Kosovë.

OO 72% e të anketuarve mbështesin emigrimin e serbëve nga Kosova, duke konsideruar se kushtet e jetesës për komunitetin serb në Kosovë janë të pabarabarta.

## Urbanizmi

Edhe pse të llojit rural, me pretendimin e autoriteteve lokale që vendbanimet dhe qendrat më të mëdha rurale në komunat e Graçanicës, Shtërpçës, Parteshit dhe Ranillugut të urbanizohen, këto komuna po vuajnë pasojat e urbanizimit të komunave fqinje. Prishtina, Fushë Kosova dhe Lipjani në procesin e urbanizimit të përshpejtuar kanë lënë pasojat të përhershme për mjedisin, jo vetëm në komunat e tyre por edhe ato fqinje. Megjithatë këto janë mjedise urbane që në disa aspekte ofrojnë avantazhe ndaj zonave rurale (ato janë më të dendura, zënë më pak hapësirë për banor, janë më efikase në shpërndarjen e ujit, rrymës, rrugëve dhe kanë shërbime më të mira për mbeturina etj.) ndikimi i tyre negativ në mjedis është shumë më i madh në krahasim me zonat rurale. Ndikimi negativ në mjedis rritet me emigracionin e pakontrolluar, i cili manifestohet nëpërmjet rritjes së dendësisë të popullsisë (mbipopullimi) në zonat urbane, ndërtimet pa asnjë kriter urbanistik në periferi, për shkak të mungesës së infrastrukturës, nëpërmjet shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve, hedhjes të pakontrolluar të

mbetjeve gjatë ndërtimit, rritjes së sasisë së ujërave të zeza të patrajtuara të përfundojnë në mjedis.

Afërsia e qyteteve përreth, konfigurimi i terrenit, si dhe copëzimi i vendbanimeve në këto komuna, janë elemente të përshtatshme për shkelësit e ligjit dhe shpesh këto komuna përballen me deponi ilegale (mbetje komunale dhe inerte) në kufijtë me komunat fqinje, mbetjet industriale dhe komunale, ujërat e papërpunuara që derdhen në lumenj dhe përrenj, që për shkak të nivelit të ulët të ujit dhe terrenit të rrafshët mbesin më gjatë në territorin e komunës, gjë që drejtpërdrejt rrezikon mjedisin.

## Trafiku

Edhe pse nuk ka linja të transportit lokal, gjë që vështirëson lëvizjen e popullatës lokale, qarkullimi i trafikut në komunën e Graçanicës është i lartë. Në këtë kontribuojnë veprimtaria dhe prodhimtaria në zonën industriale Obiliq – Fushë Kosovë – Prishtinë – Lipjan, autostradat, rrugët magjistrale. Trafiku është shumë i dendur dhe është një nga burimet kryesore të ndotjes së mjedisit: ndotja e ajrit për shkak të zhvillimit të vullshëm të sektorit të transportit, niveli i lartë i përdorimit të automjeteve të vjetra, furnizimi i kufizuar me ujë, zvogëlimi i sipërfaqeve të gjelbra për shkak të shkallës së ndërtimit etj. Të gjithë këta faktorë kanë ndikim në cilësinë e ajrit dhe ujit, të cilët janë tregues shumë të rëndësishëm të ndotjes së mjedisit. Komunat tjera me shumicë serbe, përveç Komunës së Shtërpçës, e cila ka probleme të ngjashme për shkak të turizmit në Brezovicë, përballen me këto probleme në një masë më të vogël.

## Përdorimi i tokës dhe mbulueshmëria

Një nga format e drejtpërdrejta të ndikimit në mjedis është shfrytëzimi i resurseve natyrore. Format më të zakonshme të shfrytëzimit të resurseve natyrore lidhen me shfrytëzimin e

ujit, shfrytëzimin e tokës, si dhe shfrytëzimin e masës drusore. Të dhënat tregojnë se pjesa më e madhe e ujit përdoret nga ujësjellësi publik për furnizimin me ujë të pijshëm të amvisërive dhe për nevojat e konsumatorëve të tjerë të kompanive publike të ujësjellësit dhe kanalizimit. Bujqësia po ashtu konsiderohet si një sektor zhvillimor ku uji përdoret kryesisht për ujitjen e tokës bujqësore.

Në komunat e përfshira në këtë hulumtim, toka bujqësore zë niveli më të lartë të përdorimit të tokës, e ndjekur nga toka ndërtimore, uji dhe pyjet.

Me qëllim të parandalimit të ndërtimeve pa leje dhe mbrojtjes së tokës bujqësore, Komuna e Graçanicës në vitin 2018 ka miratuar Vendimin për ndalimin e shndërrimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore jashtë zonës së ndërtimit të lejuar.

Edhe pse përqindja e pyjeve në këto komuna është e vogël, shfrytëzimi i masës drusore është një sfidë për komunat.

Në vitin 2019, në jug të Graçanicës, në Zonën Kadastrale të Sushicës, në një zjarr të shkaktuar nga faktori njerëzor u dogjën dhjetëra mijëra fidanë të rinj të pyllit me pisha.

## Presionet (rreziqet) mbi mjedisin

Presionet mbi mjedisin përshkruajnë zhvillimet në ambient që rezultojnë me çlirimin e substancave fizike dhe biologjike, përdorimin e burimeve dhe përdorimin e tokës gjatë aktiviteteve njerëzore. Presionet e ushtruara nga shoqëria përfaqësojnë një sërë procesesh që krijohen kur ndryshojnë kushtet mjedisore.

Për të lehtësuar vlerësimin e ndikimeve mjedisore, praktikohet grupimi i ndikimeve sektoriale sipas aktiviteteve ekonomike, të cilat në realitet trajtohen si sektorë të veçantë. Disa aktivitete ekonomike si p.sh. energjetika, industria, transporti etj. janë pa

dyshim burimet me ndikimin më të dukshëm në mjedis, ndërsa bujqësia dhe pylltaria janë në një proporcion tjetër me mjedisin dhe si të tilla varen nga gjendja e mjedisit. Turizmi është një sektor ekonomik, efektet e të cilit në mjedis janë identifikuar kohët e fundit.

Marrja në konsideratë e ndikimit të sektorëve në mjedis është një avantazh, veçanërisht në planifikimin zhvillimor dhe hartimin e strategjive të ngjashme. Përveç shqyrtimit individual të ndikimeve sektoriale, është gjithashtu interesante të merren parasysh fushat ku ka ndikim të veprimeve të përbashkëta të sektorëve të ndryshme.

## Energjia

Energjia luan një rol të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm në mënyrën moderne të jetës njerëzore, por ndikimi i saj në mjedis është gjithashtu i spikatur. Çdo mënyrë e prodhimit të energjisë ka një ndikim të ndjeshëm mbi mjedis për shkak të operacioneve që i shoqërojnë nga sigurimi i materialit të parë (repromaterialit) dhe transportit, e deri te procesi i prodhimit dhe përdorimit të energjisë. Duke qenë se Kosova furnizohet me energji nga djegia e linjtit, ndikimi i kësaj djegie lë pasojë në mjedis. Distanca ajrore prej 20-50 km në juglindje të Obiliqit shpeshherë nuk është pengesë që emetimi i grimcave të dëmshme, pluhurit dhe kombinimeve të krijuara nga procesi i prodhimit të energjisë të arrijë në tokë dhe ujë në të gjithë territorin e Kosovës përmes ajrit. Për të prodhuar energji termale, 90% e amvisërive, institucioneve, objekteve industriale, kompanive private dhe objekteve hoteliere në komunat që ishin pjesë e hulumtimit përdorin burime jo të ripërtërishme, siç janë masa drusore dhe qymyri. Përdorimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë nuk është i përfaqësuar në këto komuna.

## Industria

Industria është çelësi i zhvillimit ekonomik, ndonëse në të njëjtën kohë ka ndikimin më të madh në mjedis. Për shkak të zhvillimit

industrial shpenzohen resurset si p.sh. burimet e energjisë, ujit dhe resurset tjera. Nga veprimtaria industriale lirohen emetimet në ujë, ajër dhe tokë. Prodhimi i mbeturinave nga shumë industri është një segment që ndikon më shumë në mjedis.

Struktura e industrisë dhe teknologjia ka qenë dhe vazhdon të jetë e pafavorshme për shkak të dominimit të industrisë ekstensive që mbështetet në shfrytëzimin e qymyrit dhe xeheve të metaleve. Shumë ndërmarrje shoqërore të privatizuara nuk funksionojnë ose funksionojnë me vështirësi për shkak të teknologjisë së vjetruar dhe mungesës së financimit të teknologjive të reja. Ndikimet e kompanive të tilla në mjedis janë të dukshme në ndotjen e ajrit, ujit, tokës dhe gjenerimin e mbeturinave. Sasia e mbeturinave të grumbulluara gjatë aktiviteteve industriale të periudhës së mëparshme është e madhe dhe ka nevojë për investime për largimin e tyre. Mbeturinat industriale – djerrina në Graçanicë, e cila u krijua gjatë periudhës së funksionimit aktiv të minierës në Kishnicë është një “bombë mjedisore” për të cilën me dekada nuk është gjetur zgjidhje adekuate për sanim dhe largim. Ekzistimi i një djerrine të hapur, e cila në vete përmban komponime toksike, si dhe metale të rënda, paraqet rrezik për mjedisin më të gjerë - ajrin, tokën, ujin (rrjedha e lumit Graçankë, Sitnicë, Ibër, liqeni i Graçanicës), por më së shumti për shëndetin e njeriut.

Në Komunën e Graçanicës janë të regjistruara 703 ndërmarrje, firma.

Edhe pse nuk regjistrohet një përqindje të madhe të prodhimit industrial në territorin e saj, Komuna e Graçanicës përballet me mbeturinat e prodhuara nga impiantet industriale jashtë kufijve të saj. Proceset industriale si pompimi i ujit nga gropat e minierave, prodhimi i çimentos, betonit, përpunimi i gomës, plastikës, përpunimi i ushqimit dhe mishit, prodhimi i pijeve alkoolike dhe joalkoolike, prodhimi i ngjyrave dhe llaqeve etj. ndikojnë drejtpërdrejt në

mjedis (uji, ajri, toka, gjenerimi i mbeturinave, emetimi i zhurmës dhe efektet e ekosistemit). Të shoqëruara nga emetimet në ajër (SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, pluhuri dhe CO<sub>2</sub>), aktivitetet industriale rrisin ndikimet mjedisore. Derdhja e ujit të patrajtuar në rrjedhat e lumenjve (Graçankë, Sitnicë, Zhegovkë) dhe zënia e sipërfaqes së tokës për deponimin e mbeturinave industriale krijojnë presione të drejtpërdrejta që ndikojnë në mjedisin dhe shëndetin publik të banorëve.

## Transporti

Ky sektor ndikon në cilësinë e përgjithshme të mjedisit, veçanërisht në zonat urbane dhe ato në afërsi, siç është Komuna e Graçanicës. Shumica e automjeteve përdorin dizellin, që nënkupton çlirimin e emetimeve në ajër, ujë dhe tokë. Ndërtimi i rrugëve po ashtu ndryshon peizazhin dhe tokën dhe në 20 vitet e fundit rrjeti rrugor është zgjeruar ndjeshëm në komunë, duke përfshirë edhe degradimin e mundshëm të habitatit. Automjetet e papërdorshme gjithashtu paraqesin rrezik serioz për mjedisin.

Rritja e popullsisë në Kosovë dhe rritja e automjeteve dhe nevoja për lëvizje konsiderohen si shtysa kryesore për zhvillimin e këtij sektori dhe rritjen e ndikimit në mjedis. Për shkak të rritjes së numrit të automjeteve, cilësia e dobët e derivateve vlerësohet si një shtytës që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ndotjen e ajrit dhe mjedisit në përgjithësi. Transporti gjithashtu ndikon në mjedis me zënie të zonave dhe ndryshim të qëllimit të tyre për përdorim të tokës bujqësore dhe tokës tjetër.

Banorët e Komunës së Graçanicës përdorin automjetet si llojin kryesor të transportit e që është pasojë e organizimit joadekuat të transportit urban (mungesa e linjave të autobusëve). Komunikacioni më i madh në komunë zhvillohet në autostrada, rrugë magjistrale dhe rajonale që kalojnë nëpër Komunën e Graçanicës. Në qarkullimin rrugor kontribuojnë edhe afërsia e Prishtinës,

si dhe zonat industriale të cilat pjesërisht gjenden në territorin e komunës. Ndikimet negative pasqyrohen në rritjen e emetimit të substancave të dëmshme në ajër të shkaktuar nga djegia e karburantit (12% i përket transportit, 75% industrisë së energjisë), zhurma dhe dridhjet në rritje, të cilat mund të lënë pasojë tek speciet e caktuara, të dëmtojnë trashëgiminë kulturore dhe fetare.

Me këtë problem ballafaqohen edhe komunat tjera në jug të lumit Ibër. Në të gjitha komunat nuk ka transport publik të organizuar, kështu që transporti bëhet pothuajse ekskluzivisht me automjete private.

## Bujqësia

Nga viti 2000, numri i banorëve në Graçanicë është në rritje të vazhdueshme, ndërsa numri i banorëve në komunat përreth pothuajse është dyfishuar. Rritja e popullsisë dhe rritja e kërkesës për ushqim konsiderohen shtysa kryesore për zhvillimin e këtij sektori dhe rritjen e ndikimit në mjedis. Zgjerimi i vendbanimeve dhe urbanizmi karakterizohen si shtytës që kanë ndikuar drejtpërdrejt në zvogëlimin e sipërfaqes bujqësore (14% e tokës bujqësore u shndërrua në tokë ndërtuese në vitet 2000-2015). Për të parandaluar këtë trend të keq dhe për të ruajtur tokën bujqësore, Komuna ka miratuar Vendimin për ndalimin e shndërrimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore jashtë zonës së ndërtimit të lejuar.

Ndryshe nga zvogëlimi i sipërfaqes së tokës bujqësore, është rritur sasia e përdorimit të plehrave artificiale, kimikateve dhe produkteve të tjera kimike me ndikim në mjedis.

Komunat e Parteshit, Novobërdës, Ranillugut dhe Kllokotit janë komuna në të cilat bujqësia është pothuajse burimi i vetëm i të ardhurave, me përjashtim të institucioneve publike. Në këto komuna, përveç Komunës së Novobërdës, nuk ka Plane të Veprimt dhe Strategjike për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe bujqave, gjë që ndikon dukshëm në trendin e rënies së aktiviteteve bujqësore në vitet e fundit.

Në Komunën e Ranillugut ka një problem serioz për shkak të gërmimit në lum. Në një bisedë me banorët e zonës mësuam se disa kompani po gërmojnë shtratin e lumit Moravë e Binçës për të shitur rërë ilegalisht. Komuna ka kohë që po përballet me këtë problem, por pa sukses. Problemi lind për shkak se shtrati i lumit është gërmuar në vende shumë të rrezikshme dhe në disa pjesë lumi thahet, gjë që është problem për bujqit që e përdorin atë për të ujitur të mbjellat e tyre dhe nga ana tjetër lumi ndalet, përmbyt, krijohen pellgje që më pas janë të përshtatshme për ndotje.

Spektori i bujqësisë, i cili është departamenti kryesor për prodhimin e ushqimit, ka një ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin publik. Cilësia e produkteve bujqësore, cilësia e tokës që përdoret për prodhimin e ushqimit, si dhe ndikimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësore nga produktet kimike të përdorura në bujqësi janë vetëm disa nga format e ndikimit në shëndetin publik, megjithëse nuk ka të dhëna apo kërkime specifike për të vlerësuar këtë ndikim.

## Pylltaria


Pyjet janë ekosistemi natyror më kompleks që kanë një rëndësi të madhe ekologjike, ekonomike dhe shëndetësore. Pyjet janë një rregullator natyror i klimës, mbrojnë cilësinë e ujit dhe ajrit dhe mbrojnë tokën nga erozioni dhe kullimi i shtresës prodhuese. Gjithashtu, pyjet janë grumbulluesit më të mëdhenj të CO<sub>2</sub> në tokë, si dhe furnizuesit kryesorë të atmosferës me oksigjen. Janë burime natyrore të ripërtërishtme, produktet e të cilave mund të përdoren në industrinë e ngrohjes dhe qëllime të tjera. Pyjet janë ekosisteme në të cilat rriten një numër i madh i llojeve të bimëve dhe kafshëve, të cilat kanë një rëndësi të madhe ushqyese dhe mjekësore për njerëzit. Përveç që parandalojnë erërat e forta, përfaqësojnë edhe një mjedis për pushimin e njerëzve.

Rëndësia e të gjithë këtyre elementeve duhet të jetë prioritet i të gjitha atyre komunave

të cilat, si Graçanica, kanë një përqindje jashtëzakonisht të ulët të sipërfaqes pyjore (450 ha). Aty ku nuk ka mundësi pyllëzimi, alternativat janë brezat e gjelbër, rrugët e gjelbra, mushkëritë e gjelbra që duhen përforcuar. Megjithatë, Komuna e Graçanicës nuk ka bërë përpjekje për të pyllëzuar zona dhe territore të caktuara aty ku është e mundur. Pylli afër fshatit Shashkoc u dogj në vitin 2019 dhe që atëherë komuna nuk ka dalë me plan për ripyllëzimin e këtij pylli.

Komunat Novobërdë dhe Partesh, të cilat kanë sipërfaqe pak më të mëdha pyjore, po përballen me problemin e vjedhjes së pyllit. Pas përpunimit të intervistave me ta, mësuam se këto komuna nuk kanë as pylltarë e as kapacitete për të parandaluar vjedhjen e pyjeve. Komunikimi me policinë është shpesh tejte jofunksional dhe i ngadalshëm, ku reagimi ndaj një denoncimi për vjedhje pylli është shumë i ngadaltë dhe joadekuat.

Komunat e Ranillugut dhe Shtërpcës po ashtu përballen me probleme të ngjashme, por në një masë më të vogël.







# Synimet e studimit dhe metodologjia

## Synimet

Synimi kryesor i këtij hulumtimi është të hulumtojë kapacitetet e pushteteve lokale me popullatë shumicë serbe në Kosovë, në jug të lumit Ibër. Në përputhje me këto synime, do të përpiqemi ta konkretizojmë hulumtimin konceptual përmes qëllimeve specifike si më poshtë.

○○ Avokimi i pushtetit lokal në mbrojtjen e mjedisit.

Ky qellim përfshin ekzaminimin e departamenteve kompetente komunale dhe kapacitetet e tyre për të kryer punën e tyre që lidhet ngushtë me mbrojtjen e mjedisit (departamentet e inspektimit, shërbimeve publike dhe emergjencave, buxhetit dhe financave, bujqësisë dhe pylltarisë).

○○ Gatishmëria dhe kapacitetet e pushtetit lokal për të zgjidhur problemet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit

Me këtë qëllim duam të shqyrtojmë nëse komunat kanë kapacitete të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha detyrimet ligjore në lidhje me mbrojtjen e mjedisit.

○○ Institucionet e tjera a janë të përkushtuara mjaftueshëm për ruajtjen e mjedisit.

Në veçanti, ky qellim përfshin kontrollimin e institucioneve të tjera publike në pushtet lokal, të cilat ligjërisht janë të detyruara të kujdesen për mjedisin (policia, sektori privat, gjyqësori, etj.).

○○ Funksionaliteti i aparatit institucional në parandalimin e kërcënimeve mjedisore

Së fundmi, me këtë qëllim duam të shqyrtojmë nëse pushtetet lokale kanë mjete të mjaftueshme logjistike për të përmbushur detyrimet e tyre ligjore në lidhje me ruajtjen e mjedisit.

## Metodologjia

### Metodologjia dhe struktura e mostrës kuantitative

Anketë sy me sy në teren e realizuar në periudhën tetor-nëntor 2021. Gjithsej 500 qytetarë të kombësisë serbë janë anketuar në mbarë Kosovën. Pyetësi përbëhet nga 46 pyetje dhe mbulonte gjithsej 6 fusha. Mostra ishte e qëllimshme, me kuotë, ndërsa kriteri për përcaktimin e kuotave ishte madhësia e komunës së banimit. Intervali i besimit është +/- 5. Shpërndarja sipas vendbanimit është më sa vijon:

Komuna:				
	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Leposaviq	110	22.0	22.0	22.0
Kamenicë	10	2.0	2.0	24.0
Novobërdë	30	6.0	6.0	30.0
Zubin Potok	50	10.0	10.0	40.0
Shtërpçë	30	6.0	6.0	46.0
Zveçan	60	12.0	12.0	58.0
Graçanicë	60	12.0	12.0	0.0
Ranillug	30	6.0	6.0	76.0
Partesh	10	2.0	2.0	78.0
Kllokot	10	2.0	2.0	80.0
Mitrovicë Veriore	100	20.0	20.0	100.0
<b>Gjithsej</b>	<b>500</b>	<b>100.0</b>	<b>100.0</b>	

Në mostër ishin gjithsej 60% burra dhe 39.8% gra. Moshë mesatare e respondentëve ishte 42 vjeç. 5.4% të të anketuarve kishin të përfunduar shkollën fillore, 47% të mesmen dhe 45% të të anketuarve ishin me shkollë të lartë, respektivisht fakultet. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 25.9% janë të punësuar, ndërsa 58% dhe 42% nuk punojnë ose janë në pension. Është e rëndësishme të theksohet se, duke pasur parasysh faktin se nuk ka statistika zyrtare për strukturën demografike të popullsisë së synuar, d.m.th. të popullsisë serbe në Kosovë, mund të flasim vetëm kushtimisht për përfaqësimin e mostrës.

## Metodologjia dhe dizajni i hulumtimit kualitativ

### Fokus grupet

**Koha:** Hulumtimi është kryer nga tetori i vitit 2021 deri në dhjetor të vitit 2021

**Instrumenti i hulumtimit:** Udhëzuesi për bisedë me 10 pyetje

**Numri i fokus grupeve:** 6 fokus grupe

**Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve:** 48 pjesëmarrës (8 pjesëmarrës në secilin fokus grup)

Kriteret për përzgjedhjen e pjesëmarrësve: Pjesëmarrësit e fokus grupeve janë zgjedhur në bazë të kriterëve të mëposhtme: gjinia, moshë, vendbanimi, lloji i punësimit (këtu jemi përpjekur të përfshijmë më së shumti punëtorët e institucioneve publike, por edhe të sektorit privat, si dhe dy pjesëmarrës nga sektori civil dhe media)

## Intervistat

**Koha:** Hulumtimi është kryer nga shtatori i vitit 2021 deri në dhjetor të vitit 2021

**Instrumenti i hulumtimit:** Udhëzuesi për intervista me 7 pyetje, pyetje të përshtatura për profesionin e personit të intervistuar

**Numri i përgjithshëm i të intervistuarve:** 12 të intervistuar


Kriteret për përzgjedhjen e bashkëbiseduesve: Të intervistuarit ishin kryesisht të punësuar në pushtet lokal në sektorë të lidhur me temën e hulumtimit, ndërsa ishte përfshirë edhe një pjesë më e vogël e personave nga sektori civil.

**Bashkëbiseduesit:** Të gjitha intervistat ishin anonime për shkak të situatës së ndjeshme socio-politike në këto komuna



# Rezultatet e hulumtimit

**Grafikoni 1.** A ka komuna juaj një strategji të miratuar për mjedisin apo plan të veprimit lokal për mjedisin?




Të anketuarit e intervistuar përmes intervistave të thella dhe fokus grupeve theksuan se nuk ishin në dijeni nëse komuna e tyre kishte miratuar ndonjë strategji në lidhje me çfarëdo plani mjedisor. Kur i kemi pyetur për arsyen, kryesisht kemi marrë përgjigje se nuk e dinë se ku mund ta verifikojnë këtë informacion, ndërsa disa të anketuar të fokus grupeve janë përgjigjur se informacione të tilla duhet të ishin në ueb faqen zyrtare, por se lundrimi në këto ueb faqe zyrtare shpesh është konfuz. Në intervistat me personat nga pushteti lokal më së shumti kemi hasur në përgjigjen se strategjitë janë në hartim dhe

se nuk po miratohen sepse nuk ka mjete të mjaftueshme buxhetore për t'i zbatuar ato.

Qytetarët e anketuar në 62.8% të rasteve nuk e dinë nëse komuna e tyre ka miratuar një plan strategjik apo lokal për ekologji, ndërsa 11% e tyre pohojnë se komuna e tyre ka miratuar një strategji apo plan veprimi.

**O Grafikoni 2.** Vlerësoni zbatimin e planit nëse komuna e juaj ka miratuar një dokument strategjik/Leap




Në intervistat e thelluara të kryera me punëtorët e pushtetit lokal për çështjen e vlerësimit të zbatimit aktual të planeve lokale ekologjike, morëm kryesisht të njëjtat përgjigje, d.m.th. se këto plane veprimi nuk kanë prioritet dhe se fokusi i pushtetit lokal në 4-5 vitet e fundit ka qenë kryesisht në zgjidhjen e çështjeve sociale dhe ekonomike të qytetarëve të tyre. Në vitin 2019, OJQ-ja Komunikimi për Zhvillimin e Shoqërisë ka monitoruar të gjitha planet e veprimit të miratuara nga komunat në vitin paraprak dhe sa i përket zbatimit të Planit Lokal të Veprimit Ekologjik, vlerësimet kanë qenë shumë të ulëta, gjë që pa mëdyshje tregon se komunat nuk i përmbushin detyrimet e tyre në kapacitet të plotë në zbatim të këtyre planeve të veprimit. Të anketuarit në grupet e fokusit përgjithësisht pajtohen se në vitet e fundit fokusi nuk ka qenë te ekologjia, por te pandemia, dhe besojnë se pandemia

Covid19 ka ndikuar ndjeshëm që përqendrimi të zhvendoset nga çështjet e mbrojtjes së mjedisit.

Në intervistat me përfaqësues të sektorit civil, u konstatua se pushteti lokal nuk ka kapacitet të mjaftueshëm dhe vullnet për të zbatuar plane të tilla.

Qytetarët e anketuar kanë mendim të ndarë, 32.7% e tyre mendojnë se këto plane strategjike dhe veprimi janë duke u zbatuar, ndërsa 29% mendojnë se zbatimi është gjysmak, ndërsa 27% mendojnë se shumë pak zbatohen.

**Grafikoni 3.** Vlerësoni angazhimin e komunës tuaj në mbrojtjen e mjedisit




Shumica e të anketuarve nga fokus grupet konsiderojnë se pushteti lokal nuk është sa duhet i përkushtuar ndaj fushës së mbrojtjes së mjedisit, gjë që pasqyron edhe situata në terren. Shumica e tyre janë shprehur se problemet ekologjike vetëm se janë përkeqësuar në 20 vitet e fundit dhe janë pesimistë për përpjekjet e ardhshme të komunës për zgjidhjen e problemeve. Nga fokus grupet të anketuarit më elokuent ishin ata nga Graçanica, të cilët në detaje prezantuan problemet që janë bërë më të mëdha dhe konsiderojnë se pushteti lokal nuk ka arritur të gjejë zgjidhje për këto probleme. Të anketuarit nga Shtërpca, nga ana tjetër, kanë deklaruar se institucionet qendrore dhe sektori privat po i dëmtojnë përpjekjet e pushtetit lokal kur është fjala për problemin e mini hidrocentraleve. Në intervistat e thelluara me përfaqësues të sektorit civil u tregua se ndërgjegjësimi për mbrojtjen e

mjedisit është tejet i ulët, sepse nuk është diçka më rendësi për njerëzit dhe ky konsensus i popullatës transmetohet edhe te pushteti lokal. U fol edhe se situata politike është e tillë që pushtetet lokale duan të jenë sa më të dukshme për qytetarët e tyre në punën e tyre, ndërsa temat që nuk janë të rëndësishme për qytetarët nuk janë as për ata.

Të njëjtën pyetje ia kemi bërë edhe qytetarëve përmes hulumtimit në anketë dhe 62% e tyre besojnë se pushteti lokal nuk është i përkushtuar sa duhet në mbrojtjen e mjedisit.

**O Grafikoni 4.** Sa e rëndësishme është mbrojtja e mjedisit për juve personalisht dhe a e konsideroni të rëndësishme mbrojtjen e mjedisit



Kur i kemi pyetur pjesëmarrësit e fokus grupeve sa është e rëndësishme mbrojtja e mjedisit për ta, të gjithë njëzëri u pajtuan se mbrojtja e mjedisit është shumë e rëndësishme, por njëkohësisht u shprehën se çështjet ekonomike dhe sociale janë shumë më e rëndësishme për ata, gjë që deri diku konfirmon pretendimet nga pyetja e mëparshme.


Në intervistën e thelluar, përfaqësues të medias dhe shoqërisë civile besojnë se në komunat e pazhvilluara me një shkallë të lartë të personave të zhvendosur dhe në përgjithësi në gjendje të renduar ekonomike dhe të sigurisë, nuk mund të presim që njerëzit të shqetësohen tepër dhe mbrojtja e mjedisit të jetë e rëndësishme për ta. «Kur shumica e

madhe e njerëzve në komunat e Anamoravës planifikojnë të largohen, kur keni një situatë të tillë në terren, me çrast njerëzit nuk shohin të ardhme në këto anë, për ata thjesht nuk mund të jetë prioritet mjedisi i tyre aktual dhe me këtë vjen edhe mosrespektimi për mjedisin.»

Nga ana tjetër, hulumtimi në anketë pasqyron një realitet tjetër, i cila është se 39.6% e të anketuarve mendojnë se mjedisi është shumë i rëndësishëm për ta, ndërsa 22.8% mendojnë se ndotja e mjedisit është problemi më i rëndësishëm për tu zgjidhur. Përfaqësuesit e pushtetit lokal në intervistat e thelluara theksuan se është shumë e rëndësishme që të zgjidhen problemet mjedisore dhe se kjo duhet të jetë prioritet, sepse, siç thonë ata, do të reduktonte emigrimin e popullsisë..




**O Grafikoni 5.** Sipas mendimit tuaj, në çfarë masë rrezikohet mjedisi nga sjellja e papërgjegjshme e qytetarëve



Çështja e mbeturinave në hapësirat publike në Kosovë ka qenë gjithmonë problem. Kultura dhe vetëdija ekologjike janë në një nivel shumë të ulët, andaj nuk është e pazakontë që menjëherë brenda dy ose tre ditësh të mbushet me mbeturina një zone publike e sapo pastruar. Kjo fotografi është e njohur për të gjithë në Kosovë dhe në mbarë rajonin. Deponitë ilegale ekzistojnë pothuajse në çdo fshat, në disa më shumë se një dhe si të tilla paraqesin problem, por problemi më i madh janë deponitë që krijohen në shtretërit e lumenjve ku qytetarët e pandërgjegjshëm vazhdimisht hedhin mbeturina. Pothuajse të gjithë të anketuarit u pajtuan se ne vet jemi problemi më i madh për mjedisin, respektivisht trajtimi ynë i pandërgjegjshëm. Të anketuarit nga fokus grupet, intervistat e thelluara dhe anketat që kemi kryer tregojnë një mendim dhe qëndrim të qartë se trajtimi i pandërgjegjshëm i mjedisit nga ana

qytetarëve është një nga shkaqet kryesore të kushteve të këqija mjedisore. Me intervistën e thelluar me përfaqësues të pushtetit lokal, më saktë të drejtorive të inspektoratit, mësuam se nuk funksionon i gjithë sistemi dhe mekanizmi – komunikim i dobët me institucionet qendrore, mungesa e fondeve, mungesa e ekspertëve të fushës, mungesa e fuqisë punëtore, si dhe mosekzistimi i politikave kanë çuar në rezultate dëshpëruese në çdo kapacitet për të trajtuar në mënyrë efektive problemet mjedisore. Qëndrim të ngjashëm kanë edhe të anketuarit nga fokus grupet, d.m.th. se trajtimi jonë i pandërgjegjshëm ndaj mjedisit nis nga një sistem joefikas. Të anketuarit, 55.8% prej tyre, janë të mendimit se sjellja e pandërgjegjshme e qytetarëve është faktori kryesor i rrezikimit të mjedisit dhe 31% e tyre janë të mendimit se trajtimi i pandërgjegjshëm ndaj mjedisit ndikon në masë të madhe.

### O Grafikoni 6. Mosndëshkimi i subjekteve që rrezikojnë mjedisin



Ndëshkimi i atyre që rrezikojnë mjedisin është një nga mekanizmat më efektivë për mbrojtjen e mjedisit. Ky mekanizëm është në përgjithësi i pranuar në të gjitha vendet e zhvilluara dhe mund të bëhet një paralele midis zbatimit të rreptë të këtyre masave dhe zhvillimit të një vendi, si dhe gjendjes pozitive të mjedisit.


Në Kosovë, kjo praktikë ende nuk është zbatuar, siç konfirmohet nga të anketuarit në intervista të thelluara. "Në mjediset dhe komunat më të vogla me shumicë serbe, në jug të lumit Ibër, numri i banorëve është shumë i vogël, kështu që të gjithë njohin njëri-tjetrin. Mekanizmi i raportimit dhe ndëshkimit nuk mund të jetë efektiv sepse askush nuk dëshiron t'i «bëjë keq fqinjit të tij», kështu që edhe kur ka raportime apo situata që dikush duhet të ndëshkohet, kjo zakonisht bëhet vetëm me vërejtje. Problemi më i madh është me subjektet private që nuk ndëshkohen, nëse korrupsioni ndikon në këtë mbetet si pyetje

për tu verifikuar nga shërbimet kompetente".

Opinionet e të anketuarve të grupeve të fokusit ishin të ndara, përderisa disa mendonin se ndëshkimi nuk mund ta zgjidhte problemin sepse njerëzit do të gjenin gjithmonë mënyra për të «mashtuar» mekanizmin, të tjerët besonin se ky mekanizëm ishte më efektiv nëse zbatohet plotësisht.

Qytetarët në anketë kishin këto qëndrime: 54.2% të tyre mendojnë se mosndëshkueshmëria e subjekteve për rrezikim të mjedisit ndikon negativisht në mbrojtjen e mjedisit, ndërsa 33.8% e tyre mendojnë se rrezikon në masë më të madhe.


**O Grafikoni 7.** Mungesa e mjeteve logjistike dhe buxhetore për ruajtjen e mjedisit të shëndetshëm



Në bashkëbisedimin me përfaqësuesit e pushtetit lokal dhe të sektorit civil në të gjitha komunat, arritëm në përfundimin se pushtetet lokale nuk kanë mjetet e nevojshme logjistike apo buxhetore për të përmbushur detyrat e tyre të përcaktuara me ligj për mbrojtjen e mjedisit. Kjo është veçanërisht e dukshme në komunat e Kllokotit dhe Parteshit. Buxheti vjetor i këtyre komunave është shumë i vogël dhe shumë pak ndahet për logjistikën që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit, në radhë të parë makinerinë dhe personelin e paguar në shërbimet publike. Kllokoti pothuaj nuk ka logjistikë dhe gjendja atje është zona më drastike, hapësirat e gjelbra jo të kositura, mos pastrimi i mbeturinave, e gjitha ka sjellë faktin që popullata e kësaj komune vet i çon mbeturinat në deponi ilegale, kurse mirëmbajtja e sipërfaqeve publike varet nga aktiviteti vullnetar i banorëve. Në komunat tjera ka mekanizim dhe logjistikë, por duhet shumë më tepër. Në intervistat me kompanitë lokale të shërbimeve publike kemi marrë informacione lidhur me shumë e parave që nevojiten që të gjitha aktivitetet e këtyre kompanive publike të kryhen me efikasitet. Komuna e Graçanicës

aktualisht ka shërbimin komunal më të zhvilluar në krahasim me komunat tjera që kemi hulumtuar. Në një bisedë me përfaqësuesit e kësaj kompanie komunale mësuam se nevojitet të paktën edhe 50% më shumë buxhet për të kryer punën e tyre me 100% efikasitet. Përveç të hyrave vetanake, kjo kompani ka një pjesë të buxhetit të komunës, por e gjithë kjo nuk është e mjaftueshme që kompania të funksionojë mirë. Duke pasur parasysh se Komuna e Graçanicës ka hyrë në suficit buxhetor këtë vit dhe se kemi disa sektorë në komunë të cilëve u mungojnë mjetet materiale, është konstatuar se komuna nuk e krijon buxhetin në mënyrë optimale. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit kanë mendime të ndara. Derisa në komunat më të mëdha besojnë se ka logjistikë dhe resurse materiale të mjaftueshme për tu kujdesur për mjedisin dhe fajësojnë nepotizmin dhe joprofesionalizmin e këtyre kompanive publike për situatën e keqe, në komunat më të vogla pjesëmarrësit e fokus grupeve mendojnë se ka mungesë logjistike dhe buxheti në komunat e tyre.

### O Grafikoni 8. Mungesa e vetëdijes për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit




Ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit në dhjetë vitet e fundit është rritur në Ballkan. Siç e theksuam në përshkrimin e gjendjes së mjedisit që në fillim, është e qartë se gjendja e mjedisit në rajon është shumë e keqe, por duke ndjekur shembullin e vendeve të Bashkimit Evropian dhe duke u përpjekur për standarde më të mira, ngadalë po zgjohet ndërgjegjësimi se ruajtja e mjedisit është indikator zhvillimit të një shoqërie, si në kontekst ekonomik ashtu edhe demokratik. Megjithatë, edhe pse ndërgjegjësimi për ekologjinë dhe mbrojtjen e mjedisit po rritet ngadalë, gjendja e mjedisit në këtë hapësirë nuk ndjek tendencat e ruajtjes së tij. Në intervista të thelluara kemi pyetur bashkëbiseduesit tanë nëse ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit është në një nivel të lakmueshëm. Mendimi është se ndërgjegjësimi nuk është në nivelin që duhet të jetë, duke qenë se disa komuna po përballen me pasojat katastrofale të

rrezikimit të mjedisit. Popullata, si dhe sektori publik nuk i kushtojnë rëndësi të mjaftueshme mjedisit e as pasojave që mund të ketë për popullsi. Pjesëmarrësit e fokus grupeve kanë mendime të ndara, derisa disa besojnë se ndërgjegjësimi është në nivel të lartë, por se nuk ka infrastrukturë për të mbështetur këtë ndërgjegjësim, të tjerët besojnë se po të kishte ndërgjegjësim do të kishte edhe infrastrukturë. Të gjithë pajtohen që është detyrë e mediave, sektorit civil dhe veçanërisht e pushtetit lokal dhe qendror të rrisin këtë ndërgjegjësim, por kjo nuk po ndodh.

Të anketuarit besojnë se ndërgjegjësimi jo i zhvilluar për mjedisin dhe ekologjinë kërcënon gjendjen e mjedisit, respektivisht 58.4% prej tyre, e vetëm 2% të të anketuarve janë të mendimit se ndërgjegjësimi mjedisor nuk e rrezikon atë.


**O Grafikoni 9.** A keni denoncuar ndonjëherë ndonjë rrezik për mjedisin në ndonjë institucion kompetent



Problemi i mosfunksionimit të institucioneve në mbrojtjen e mjedisit shihet edhe në këtë grafikon, ku nga të anketuarit kuptuam nëse kanë denoncuar ndonjëherë çfarëdo kërcënimi mjedisor tek ndonjë nga institucionet kompetente. Vetëm 5.6% të tyre kanë denoncuar problemin te një institucion kompetent, ndërsa 94.4% jo. Pyetje më konkrete iu kemi bërë pjesëmarrësve të fokus grupeve, ku pjesa dërrmuese e tyre ishin dëshmitarë të rrezikimit të mjedisit, por që asnjëherë nuk e kishin denoncuar diku dhe besojnë se kjo është punë e policisë dhe inspektoratit komunal. Mirëpo, në intervistën e thelluar me përfaqësues të këtyre institucioneve morëm përgjigjen se ata nuk kanë staf të mjaftueshëm për të ndjekur të gjithë shkelësit dhe se njerëzit në përgjithësi përpiqen të mos bëjnë gjëra të tilla në praninë e tyre dhe se vazhdimisht informojnë qytetarët

se është shumë e rëndësishme që ata, qofshin persona fizikë apo juridikë, të dokumentojnë dhe të denoncojnë për të pasur një reagim. Kjo na jep një pasqyrë se institucionet nuk mund ta bëjnë këtë punë me efikasitet. Në një intervistë me përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile, kemi marrë mendimin se ky problem mund të tejkalohet me vendosjen e video vëzhgimit dhe patrullave të rregullta të policisë dhe shërbimeve të inspektoratit, pasi në disa komuna ka infrastrukturë video vëzhgimi, por e cila nuk përdoret për këtë qëllim ose është e prishur.


### O Grafikoni 10. Mosinteresimi i institucioneve lokale dhe qendrore për përmbushjen e detyrave ligjore



Të anketuarit, 51.8% e tyre konsiderojnë se mosinteresimi i institucioneve lokale dhe qendrore për ti përmbushur detyrimet e tyre ligjore e rrezikon mjedisin jetësor plotësisht, 27% e tyre konsiderojnë se mospërmbushja e

detyrimeve ligjore e rrezikon në masë të madhe. Se mospërmbushja e detyrimeve ligjore nuk e rrezikon mjedisin jetësor konsideron 3% e tyre, ndërsa 15% konsiderojnë se e rrezikon pjesërisht mjedisin jetësor.


### O Grafikoni 11. Nëse e keni bërë, ku keni denoncuar problemin



Në një kampion shumë të vogël të të anketuarve që intervistuar, të cilët iu përgjigjën me pohim pyetjes së mëparshme, i pyetëm se në cilin institucion kishin raportuar. 50% prej tyre kishin

raportuar në ndërmarrjen publike komunale, 18% në polici, 21% në komunë dhe vetëm 7% në inspektoratin komunal apo departamentin e inspektoratit brenda komunës.

**O Grafikoni 12.** Çfarë përgjigje keni marrë pas denoncimit/A është zgjidhur problemi



Nga 500 të anketuarit që synuam, vetëm 28 kishin denoncuar një problem, ndërsa nga 28, problemi ishte zgjidhur vetëm në 13 raste. Duke marrë parasysh të dhënat nga fokus grupet, ku pothuajse çdo pjesëmarrës ka qenë dëshmitar i një lloj kërcënimi mjedisor nga persona fizik ose juridik, marrim një rezultat shumë të rëndë. Këtë fenomen e kemi shpjeguar më herët në analizën pse nuk funksionojnë mekanizmat.

Intervista e thelluar me një ekspert të kësaj fushe na dha këtë përgjigje. “Është detyrë e institucioneve lokale dhe qendrore të ofrojnë mekanizma funksional. Nëse një mekanizëm nuk funksionon, ai ose duhet të avancohet ose të përdoret një tjetër dhe kështu me radhë, derisa të gjendet një mekanizëm që funksionon.

Është e qartë se ky mekanizëm, si shumë mekanizma të tjerë, nuk është funksional sepse nuk i është përshtatur realitetit shoqëror në të cilin ndodhemi. Nëse një mekanizëm funksionon në një ambient, nuk është e domosdoshme se do të funksionojë njëjtë në një tjetër. Në zonat rurale është e vështirë të gjejmë një mekanizëm funksional përse i përket ruajtjes së mjedisit sepse zakonet e mësuara nga fajnjet dhe prindërit janë rrënjësor shumë më thellë në popullsinë e zonave rurale. Duke marrë parasysh faktin se mjediset në të cilat jetojmë janë të vogla dhe që të gjithë e njohim njëri-tjetrin, fakti që ka shumë pak denoncime dhe zgjidhje të problemeve nuk është për t'u habitur. Por, kjo nuk do të thotë se nuk duhet të kërkojmë zgjidhjen e duhur.”





# Konkluzioni

Me hulumtim u konstatua se pushtetet lokale në komunat me shumicë serbe, në jug të lumit Ibër, nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për t'u kujdesur për mjedisin. Mungesa e komunikimit me institucionet qendrore, si dhe mungesa e mekanizmave efektivë janë pengesat më të mëdha për të gjitha pushtetet lokale.

Gjendja e mjedisit në këto komuna me shumicë serbe është në nivel të ulët. Për zgjidhjen e problemeve nevojiten shumë më tepër ndarje buxhetore dhe asnjë pushtet lokal nuk ka buxhete të tilla. Komunat që kanë një buxhet solid zakonisht nuk planifikojnë mirë, kështu që krijohen suficitet të mëdha, që në kushte afatgjatë do të thotë se buxhetet e këtyre pushteteve lokale do të zvogëlohen. Infrastruktura komunale në disa komuna është thuajse inekzistente, andaj problemi i mbetjeve komunale kryesisht zgjidhet derisa të arrijë në pragun e dikujt. Komunitetet bujqësore, të cilat merren edhe me blegtori, nuk kanë vende adekuate ku mund të deponojnë kafshët e ngordhura dhe mbetjet e kafshëve, kështu që këto shpesh përfundojnë në shtretërit e lumenjve ose në ndonjë skaj të fshatit.

Për sa i përket rregullativës ligjore, komunat nuk po miratojnë plane reale lokale të veprimit ekologjik dhe planet e tilla në esencë nuk mund të zbatohen. Po ashtu, në asnjë komunë nuk ka organ që mbikëqyr zbatimin e këtyre planeve, kështu që ato janë vetëm në letër, të nënshkuara dhe të votuara. Ka gjithnjë e më pak sipërfaqe të gjelbra, ndërsa planet urbane në komunat më të vogla në përgjithësi nuk ekzistojnë. Komunat e përfshira në këtë hulumtim janë kryesisht rurale, kështu që presionet mbi mjedisin drejtohen në qendrat më të mëdha urbane përreth, të cilat përmes ndërtimeve të pakontrolluara

po përhapen edhe në këto komuna rurale. Kombinimi i të gjitha rrethanave çon në përfundimin se pushteti lokal nuk mund të përballojë të gjitha presionet mbi mjedisin që ndodhin në territorin e komunës së tyre.

Ajo që linte përshtypje në bashkëbisedim me drejtorët e dikastereve relevante për këtë çështje është se në pushtetet lokale problemet shpeshherë u hidhen niveleve më të larta, nga lokale në qendrore, e nganjëherë edhe prapa. Shembull i tillë është zgjidhja e çështjes së djerrinës në Graçanicë, ku kemi marrë përgjigje se kjo çështje është ngritur disa herë nga pushteti lokal para institucioneve qendrore, megjithatë ajo është bartur në sektorin privat sepse ajo djerrinë u privatizua, kështu që çështja do të kthehet në nivel lokal e kështu në rreth, pa asnjë përgjegjësi.

Përveç të gjithave që u thanë, një pengesë tjetër janë buxhetet e komunave që janë formuar në bazë të regjistrimit të cilin popullata serbe e kishte bojkotuar pjesërisht në vitin 2011, ndaj ky fakt shpesh dëgjohet si arsye për të mos zgjidhur jo vetëm problemet mjedisore, por edhe në përgjithësi. Buxhetet e komunave më të vogla janë të pamjaftueshme dhe do të përmendim shembullin e Komunës së Novobërdës, e cila është një nga komunat më të mëdha në Kosovë për nga sipërfaqja, por ndër më të voglat për nga numri i popullsisë. Mjetet buxhetore në këtë komunë janë të mbingarkuara dhe kjo Komunë nuk mund të mbulojë të gjithë territorin e vet me shërbime komunale cilësore, e as të mbrohet dhe të vë nën kontroll vjedhjen e pyllit në territorin e saj. Në kontekst të logjistikës, një gjë e tillë është e pamundur me buxhetin aktual.

Të anketuarit nuk janë mjaftueshëm të njoftuar me mekanizmat e mbrojtjes së mjedisit. Përveç

kësaj, vetëdija se çfarë po bëhet për këtë çështje në komunën e tyre është minimale. Pushteti lokal rregullisht informon qytetarët në faqet e tyre të internetit, por është e vështirë të gjeni disa informacione për shkak të navigimit të dobët në faqet e internetit. Këtë e kanë konfirmuar edhe përfaqësuesit e sektorit civil të cilët kanë vështirësi në marrjen e informacionit të duhur.

Një gjë pozitive në gjithë këtë është se mediat lokale e trajtojnë këtë temë me shumë hollësi, ndaj nuk janë të rralla rastet që pushteti lokal të ndërmarrë iniciativa në bazë të raportimit të tyre.



# Rekomandimet

OO Investime më të mëdha buxhetore në mbrojtjen e mjedisit nga ana e pushtetit lokal

Regjistrimi i popullsisë do të mbahet në vitin 2022. Buxheti i secilës komunë formohet në bazë të numrit të banorëve në komunë pasi në vitin 2011 ky regjistrim ishte bojkotuar pjesërisht. Pushteti lokal me fushatë me kohë do të mund të theksonte rëndësinë e këtij regjistrimi, që rrjedhimisht do të siguronte mjete më të mëdha buxhetore.

OO Komunikim më transparent dhe më intensiv me institucionet qendrore për zgjidhjen e problemeve kyçe që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, si dhe bashkëpunimi me komunat fqinje për tejkalimin e pengesave që kanë të bëjnë me presionin e qendrave më të mëdha urbane dhe komunave ndaj komunave fqinje.

OO Bashkëpunim më i mirë i pushteteve lokale me sektorin civil dhe ekspertët e fushës në fazën e krijimit të strategjive dhe planeve të veprimit që përfshijnë mbrojtjen e mjedisit.

OO Pushtetet lokale, policia dhe inspektoratet duhet të zbatojnë një politikë më konkrete dhe aktive të ndëshkimit të subjekteve që rrezikojnë mjedisin, si dhe të inkurajojnë qytetarët për të qenë më aktiv në raportimin e tyre.

OO Përpilimi i strategjive mjedisore afatgjata dhe afatmesme me qëllim zgjidhjen më sistematike të problemeve në ekologji që kërkojnë zgjidhje afatgjata, siç janë problemi i djerrinave, ndotja e lumenjve, ndërtimi i mureve në vende me rrezik.


OO Rritja e kapaciteteve profesionale tek personat në drejtoritë komunale që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

OO Themelimi i komisionit për vlerësimin e të gjitha akteve ligjore dhe strategjike të cilat pushteti lokal është i obliguar të zbattoj.



STUDIMI I RASTIT:  
**LUMI GRAÇANKA**





**Autore:** Milena Zdravković

**Rreth Autorit**

Milena Zdravkovic është inxhinierë e diplomuar e arkitekturës, aktiviste shumëvjeçare socio-politike nga Kosova qendrore. Përmes punës së saj në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, punës në kuverndin lokal dhe aksioneve dhe projekteve të shumta të grupeve formale dhe joformale, ajo është afirmuar si njohëse e gjendjes së mjedisit në Kosovë.





# Përmbajtja

43 Fjala hyrëse

43 Historiati i lumit Graçanka

44 Miniera e Kishnicës

44 Mbetjet e rrezikshme industriale

45 Djerrina

46 Ndotësit e tjerë

47 Ndikimi në shëndet

47 Zgjidhjet e ofruara

49 Zgjidhja

53 Rekomandimet

55 Fjala përmbyllëse



# Fjala hyrëse

Zbatimi i qasjes së eko-sistemit ndaj problemeve komplekse të menaxhimit të ujërave është një nga sfidat më të rëndësishme në fushën e menaxhimit të këtij burimi të rinovueshëm. Ecoremediation - rehabilitimi i eko-sistemit është një koncept i menaxhimit të eko-sistemit që nënkupton tre segmente: përcaktimin e gjendjes ekzistuese të rrjedhave ujore, masat që ndërmerren me qëllim të përmirësimit të statusit ekologjik të rrjedhave ujore dhe monitorimin e ndryshimeve që ndodhin pas zbatimit të masave. Në këtë punim, fokusi është në përcaktimin e gjendjes së rrjedhjes ujore. Lumi Graçanka u zgjodh si një nga eko-problemet më të mëdha të Komunës së Graçanicës, e cila drejtpërdrejt, por edhe tërthorazi ndikon në ndotjen e mjedisit më të gjerë.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit pranë Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor në raportin e saj vjetor (2015 i vetmi i disponueshëm në gjuhën serbe) theksoi: "Lumi Graçanka – Cilësia e ujit të këtij lumi është në vazhdimësi e ndotur si rezultat i pompimit të ujërave nga minierat e Kishnicës dhe Artanës. Ka vlera të larta të përçueshmërisë elektrike dhe të jonit sulfat. Vlen të ceket se gjatë stinës së ngrohtë të verës ky lum shteron".

Përveç këtyre fakteve relevante dhe të përfshira në këtë raport, ka edhe fakte që janë anashkaluar institucionalisht, të cilat de facto ndikojnë në cilësinë e ujit në lumin Graçanka dhe atë ndotësit industrialë të njohur dhe të panjohur. Rekomandimet dhe zgjidhjet vijnë pikërisht nga formacionet dhe lokalizimi i problemit.

## Historiati i lumit Graçanka

Komuna e Graçanicës shtrihet në pjesën lindore të luginës së Kosovës, ku butësisht ngrihen shpatet e malit Veletin dhe ato më të pjerrta të malit Strazhevc nga lumi Graçanka dhe në perëndim deri te lumi Sitnicë. Graçanica ndodhet në lartësinë mbidetare 570 m dhe është pjesë e një pellgu tektonik, i cili u lëshua gjatë periudhës terciare. Është 10 km në juglindje larg nga Prishtina.

Lumi Graçanka, i quajtur sipas manastirit me të njëjtin emër nga shekulli i 14-të, kalon nëpër vendbanime Graçanicë, Llapllasellë, Preoc dhe Dobreva e Poshtme dhe derdhet në Sitnicë në dalje të Dobrevës së Poshtme. Është lumi më i madh në komunën me të njëjtin emër, në të cilin derdhet përroi Kravaricë në rrjedhën e sipërme të pellgut nga ana verilindore nga drejtimi i Hajvalisë.

Ai buron nën digën e liqenit të Badovcit dhe rrjedh pranë djerrinës së minierës së Kishnicës dhe pastaj deri te gryka e Sitnicës nëpër shumë vendbanime. Përderisa nuk kishte liqen, Graçanka ishte më e pasur me ujë dhe u formua nga lumenjtë të vogël dhe përrenjtë poshtë fshatit Llabljan dhe fshatit Mramor. Gjatësia e këtij lumi është 18,50 km.

Liqeni i Graçanicës, i njohur edhe si Liqeni i Badovcit, është akumulim artificial i ujit në lumin Graçanka. Gjendet dy kilometra në lindje të Graçanicës, i ndërtuar në periudhën 1963-1966, për ta furnizuar Prishtinën me ujë. Diga me lartësi prej 52 m dhe gjerësi prej 246 m është ndërtuar në ngushticën e Badovcit, nën malin e Androvaçës, në afërsi të minierës së Kishnicës. Kur është i mbushur, liqeni është i gjatë 3,5 km dhe i gjerë 500 m, thellësia maksimale e tij është 30 m, ndërsa vëllimi total i tij është 26 milionë metër kub ujë.

Sipas dëshmimeve të banorëve të zonës, për Graçankën flitet si një lumë i kthjellët nga i cili bujqët e lodhur pinin ujë pas punëve të rënda në fushë, si dhe fëmijët pas lojës dhe bagëtia e imtë pas kullotjes. Uji është përdorur për ujitje, por edhe si vend ku bagëtia ka pirë ujë që rriteshin në çdo familje të këtyre anëve. Dëshmohet edhe për një fond të madh peshqish që kapeshin këtu si argëtim nga vendasit, por edhe për krijesat e tjera të lumit. Sot, thonë ata, se edhe bretkoca është zhvendosur nga këtu.

Nga vitet e gjashtëdhjeta e deri më sot, lumi Graçanka ka pësuar një ngarkesë të madhe të veprimtarisë njerëzore. Urbanizimi i vazhdueshëm i kësaj zone ka sjellë një numër të madh ndërtimeve të reja, rezidenciale, biznesore, industriale, të cilat rëndojnë në disa mënyra rrjedhën ujore dhe eko-sistemin e lumit. Njëri prej tyre është rrjeti i kanalizimit i rregulluar në mënyrë të pamjaftueshme, ku të gjitha mbetjet fekale shkarkohen pa trajtim, ndërsa tjetri janë mbetjet industriale, të cilat gjithashtu derdhen pa trajtim në ujë.

Si plagë e hapur e Komunës së Graçanicës, e cila ka rreth 20.000 banorë, si dhe të lumit Graçanka, është sigurisht djerrina e hapur e mbetjeve të minierës së Kishnicës, por edhe kontaminimi i vazhdueshëm i ujit të lumit me ujërat e zeza të minierës që derdhen drejtpërdrejt pa trajtim në shtratin e lumit.

## Miniera e Kishnicës

Dikur, Kombinati xehetaro-metalurgjik "Trepça" ishte shtylla e ekonomisë së Kosovës, ndërsa xehetaria ishte dega kryesore e industrisë në Kosovë. Në kulmin e aktiviteteve të saja, në vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar, në kombinatin "Trepça" ishin të punësuar 22,500 punëtorë, ndërsa qarkullimi mesatar vjetor i ndërmarrjes ishte 100 milionë dollarë amerikanë.

Sot, shumica e uzinave të kombinatit "Trepça" janë të mbyllura, kryhet shfrytëzimi i kufizuar i lëndëve të para të mineraleve, ndërsa kombinati "Trepça" paraqet në të njëjtën kohë potencialin më të madh për rimëkëmbjen ekonomike të Kosovës dhe sfidën më të madhe mjedisore dhe burimin e varfërisë në Kosovë. Qendrat e ish-aktiviteteve të kombinatit "Trepça" në Kosovën veriore dhe lindore bartin një trashëgimi të madhe të mbetjeve toksike që kërcënojnë dhjetëra mijëra burra, gra dhe fëmijë.

Acidet e mbetjeve, grimcat e pluhurit, mënyra e pasigurtë e punës dhe mbetjet e keqmbajtura dhe të paqëndrueshme përbëjnë një rrezik të përditshëm për ata që jetojnë aty pranë. Në zonat më të ndotura janë ndotur rrugët ujore, toka e punueshme është mbushur me metale të rënda që barten në ushqim, kurse ajri përbëhet nga pluhuri që i dëmton mushkëritë.

Kombinati përfshin 3 zinxhirë basenash dhe minierash. Miniera e Kishnicës i përket zinxhirit jugor.

## Mbetjet e rrezikshme industriale

Në këtë ndërmarrje prodhohen koncentratit i plumbit, zinkut, arit dhe argjendit. Gjatë aktiviteteve punuese përdoren disa reagentë që janë të nevojshëm për procesin e flotimit. Në magazinën e flotacionit janë vendosur reagentët e ndarë sipas klasave me etiketa dhe mbishkrime të përshtatshme. Hapësirat në të cilat ruhen reagentët nuk janë të mjaftueshme dhe të sigurta. Disa prej tyre janë mjaft të korroduara dhe është i nevojshëm ri-ambalazhimi për të parandaluar rrjedhjet, si dhe pasojat për mjedisin. Në hyrje të magazinës janë vendosur shenjat e rrezikut dhe shenjat e tjera të situatave emergjente. Cianidi i natriumit (NaCN) është i ndarë nga kimikatet e tjera në magazinë në fuça të posaçme metalike që janë të vendosura në

një paletë prej druri. Megjithatë, preferohet që Cijanidi i natriumit të vendoset në një hapësirë përkatëse. Ky reagent përdoret 25 gram për ton. Gjatë punës me reagentë përdoret pajisja mbrojtëse, ndërsa punëtorët që punojnë me këto substanca duhet të jenë të kualifikuar, ndërsa sa i përket trajtimit të ujërave, veçanërisht atyre acidikë, ende nuk është marrë asnjë masë për trajtimin e tyre.

Veprimtaria: Prodhimi i koncentrit të plumbit, zinkut, arit dhe argjendit.

## Djerrina


Një nga ndotësit më të mëdhenj në Graçanicë është Kombinati xehetaro-metalurgjik "Trepça", i themeluar në vitin 1926.

Aktualisht, Trepça nuk është e sigurtë për shëndetin e popullatës që jeton në pellgun e lumit Ibër. Ajo është një kompleks i xehetarisë, flotacionit, metalurgjisë, industrisë kimike dhe përpunimit industrial. Tani punojnë vetëm pjesët e fushës nga xehetaria, impiantet e caktuara, ndërsa pjesa tjetër është në ngecje, por pavarësisht nga pjesët që janë duke punuar apo ato që janë në ngecje, Trepça ka lënë pas një pjesë shqetësuese të mbetjeve të rrezikshme dhe atë nga Hajvalia dhe Kishnica deri te Suva Ruda në Rashkë. Në një distancë prej 120 km ekzistojnë katër impiante të flotacionit që përpunojnë xehe nga një duzinë minierash, ndërsa ajo që mbetet pas tyre është e pamjaftueshme dhe shumë e rrezikshme.

Djerrina përmban edhe metale të rënda, siç është: plumbi, zinku, arseniku, antimoni, merkuri, kadmiumi, bismuti që janë helme. Pikërisht këto mbetje përmbajnë edhe reagentë të flotacionit siç janë: cianidet, sulfatet dhe hidroksidet e ndryshme, të cilat së bashku me mbetjet depozitohen në deponinë e Graçanicës ose deponinë në Badovcit.

Për një zgjidhje alarmante të problemit shumëvjeçar tregojnë disa fakte kyçe:

Djerrina e hapur në vetëm dhjetëra metra nga vendbanimi, e cila ndodhet në pjesën e ngritur të terrenit. Duke pasur parasysh kushtet klimatike dhe atmosferike, erërat dhe reshjet janë të shpeshta, gjë që çon deri te përhapja e vazhdueshme e mbeturinave në një rreze prej 20 km nga linja ajrore, ndërsa pas reshjeve të shiut dhe shkrirjes së borës, uji nga djerrina derdhet drejtpërdrejt në shtratin e lumit Graçanka dhe në këtë mënyrë e rrezikon pellgun e lumit Ibër.



## Lista e kimikateve

Nr.	Emri i kimikatit	Formula	Sasia
	Gëlqere	CaO	4500 kg
	Cianidi i natriumit	NaCN	5000 kg
	Sulfati i bakrit	CuSO <sub>4</sub>	1600 kg
	Karbonati i natriumit	Na <sub>2</sub> CO <sub>3</sub>	3000 kg
	Kaliumi Amil xanthate	KAX	1000 kg
	Kaliumi etilik xanthate	KEX	1000 kg
	Sulfati i hekurit	FeSO <sub>4</sub>	400 kg
	Sulfati i zinkut	ZnSO <sub>4</sub>	800 kg
	Dowfroth 200	C10H22O4	22000 kg/l (lloji i vajit/yn dyrës në formë të lëngshme, ngjyrë kafe e mbyllur)

**O Tabela 1** Lista e kimikateve në Flotacionin e Trepçës „Kishnicë“

Djerrina e hapur gjendet vetëm 1 km larg nga linja ajrore mbi liqenin e Graçanicës. Me ujë nga ky liqen furnizohet Komuna e Graçanicës dhe pjesa më e madhe e Komunës së Prishtinës, gjë që tregon se mbi 100.000 banorë shfrytëzohen me ujë të pijshëm nga ky burim.

## Ndotësit e tjerë

Përveç ujërave të zeza që vijnë nga gropat e minierave dhe djerrinat e hapura, të cilat me ndihmën e ujit atmosferik përçojnë ndotje në Graçankë, ky lum rrezikohet edhe nga:

1. Kanalizimi, uji fekal
2. Ujërat e zeza industriale të „ndotësve të panjohur“
3. Deponitë e egra (mbetjet komunale, ndërtime, bujqësore)

Sipas Planit zhvillimor, në të cilin publiku ka qasje, Komuna e Graçanicës është pothuajse tërësisht e mbuluar me rrjetin e kanalizimit.

Megjithatë, pjesa më e madhe e rrjetit është bërë në vitet e tetëdhjeta të shekullit të kaluar, gjë që tregon se bëhet fjalë për një rrjet të vjetëruar që shpesh kërkon ndërhyrje. Rrjeti është projektuar për katër herë më pak banorë dhe duke pasur parasysh se demografia dhe nataliteti ka ndryshuar në këtë rajon, rrjeti sot vuan nga sasia në rritje të ujërave të zeza komunale. Problemi krijohet kur rrjeti bllokohet, ku pastaj vjen deri te derdhja e ujërave të zeza. Por, edhe kjo nuk do të ishte problem nëse të gjitha ujërat e zeza nuk do të derdheshin drejtpërdrejt në lumenj, pa asnjë përpunim dhe pastrim në kolektorë.

Shtatë vitet e fundit, Graçanica shpesh ishte në qendër të vëmendjes së publikut për shkak të fenomenit endemik, e ai është lumi “kameleon” Graçanka. Gjegjësish, në pjesën e rrjedhës nëpër Llapllasellë dhe Preoc, kryesisht në muajt e verës, e herë pas here në stinët kalimtare, nga lumi përhapet një erë shumë e keqe. Banorët e kësaj komune, e veçanërisht të këtyre fshatrave, u janë drejtuar rregullisht shumë institucioneve përkatëse, inspekcioneve, komunave, ministrive. Në disa raste janë kryer analizat e ujit, në bazë të të

cilave është konstatuar se në ujë ka gjurmë të metaleve të rënda si pasojë e flotacionit, por edhe të kimikateve që tregojnë për prodhimin e llakut, ngjyrës apo bojës. Problemi nuk është zgjidhur. Në periudhën kur ndihet era e pakëndshme, lumi kalon nga ngjyra e portokalltë, gjë që është si pasojë e shpërlarjes së djerrinës, në të bardhë qumështi. Kur problemi ishte theksuar dhe merre vëmendje nga mediat, problemi zhdukej, por pas një kohe të caktuar u përsëritej e njëjta gjë. Ndotësi mbeti i panjohur, ndërsa ajo që vetëm u konstatua ishte se ky ujë i ndotur vjen nga drejtimi i Hajvalisë, e cila zonë nuk është nën juridiksionin kadastral të Komunës së Graçanicës, por të Prishtinës.

Hedhja e papërshtatshme e mbetjeve mbetet ende një pengesë e popullatës lokale. Shumë shpesh, shtretërit e lumenjve bëhen kolektorë për hedhjen e mbeturinave me origjinë të ndryshme. Mbeturinat ndërtime, bujqësore, komunale, të mëdha janë fatkeqësisht fenomene të zakonshme në Graçankë.

## Ndikimi në shëndet

Kur bëhet fjalë për shëndetin publik, ky aspekt nuk mund të shikohet në bazë të fakteve relevante. Trajtimi joadekuat i ndotësve dhe ndikimi i tyre në shëndetin publik, si dhe në mjedis, kurrë nuk ka qenë objekt i ekzaminimit të disiplinave mjekësore, shkencore dhe mjedisore.

Në periudhën kur bota është e sunduar nga pandemia Covid-19 dhe infeksionet e ndryshme shoqëruese të sistemit të frymëmarrjes, popullsia e kësaj zone është lënë në vete pa kujdesin e organeve kompetente.

Në Mitrovicën e Veriut është zbatuar studimi i testimit të mostrave përkatëse, ku është konstatuar se në shumicën e mostrave është rritur niveli i metalave të rënda në gjak, gjë që studiuesit e lidhin me djerrinat e hapura dhe deponinë e mbeturinave minerare në periferi të qytetit.

Duke pasur parasysh të njëjtin trajtim të përpunimit të xehe, teknologjinë e vjetëruar dhe joadekuate të përpunimit, si dhe distancën e ngjashme të hedhjes së mbeturinave nga vendbanimet, supozohet se rezultatet e kërkimeve dhe testeve të mundshme të mostrave në popullatën lokale nuk do të ndryshojnë në mënyrë drastike.

Përveç djerrinave që e ndotin lumin, mbetjet industriale me origjinë të panjohur krijojnë rreziqe shtesë për banorët e Llapllasellës. Në muajt e verës, kur temperaturat rriten në mënyrë të padurueshme, banorët nuk mund t'i ajrosin dhomat e tyre në asnjë mënyrë, sepse aromat e pakëndshme nga jashtë e bëjnë gjithashtu hapësirën të ndotur dhe të padurueshme. Problemi shumëvjeçar ende nuk është zgjidhur, edhe pse ka tregues se uji pompohet nga pusët me pompa uji dhe po shkarkohet në lum në mënyrë që rrjedhja e ujit të jetë më e shpejtë. Kjo metodë nuk ka të ardhme, na kushton një burim të shëndetshëm, energji dhe nuk duket se e eliminon problemin.

## Zgjidhjet e ofruara

Kur bëhet fjalë për zgjidhjet e ofruara, në opinion janë plasuar disa të mundshme, asnjëra prej të cilave nuk e pa dritën e ditës dhe as nuk ishin në listat prioritare të organeve përgjegjëse për realizimin e projekteve të tilla.

Profesora Aleksandra Ćorac, në disa diskutime dhe debate publike me temën e ndotjes, prezantoi disa nga rezultatet e hulumtimit të saj dhe pretendoi se kishte arritur një zgjidhje të mundshme shkencore. Një nga parandalimet e ndotjes së mëtejshme është pyllëzimi, përkatësisht shndërrimi i djerrinës ekzistuese në një plantacion të një lloji të caktuar bimor që do t'i thithte substancat e dëmshme të grumbulluara në mbetjet e minierave.

Rikultivimi i djerrinës është gjithashtu një nga zgjidhjet e ofruara që sjell me vete benefite, përkatësisht mundësinë e ndarjes së

grimcave të dobishme të xehe nga mbetjet e minierave, ku për shkak të përpunimit të keq dhe teknologjisë së vjetëruar në procesin e përpunimit nuk është kryer ndarja e plotë e të gjithë kapacitetit të xehe.

Si një zgjidhje tjetër nga zgjidhjet e ofruara për parandalimin e ndotjes së lumit ishte zhvendosja e djerrinës, gjë që i kontribuon popullatës lokale, por sigurisht e rrezikon ndonjë lokalitet tjetër. Ana e keqe e kësaj zgjidhjeje është investimi i shtrenjtë në shirita transportuese, periudha e gjatë e realizimit dhe mungesa e lokacioneve adekuate në një distancë të tolerueshme.

Kur bëhet fjalë për cilësinë e drejtpërdrejtë të rrjedhave ujore në Graçankë, deri më tani ka pasur disa hapa eventuale që do të kontribuonin në rezultate pozitive.

**Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për hedhjen adekuate të mbetjeve.** Duhet të theksohet se Graçanka në periudhën e pasluftës deri në vitin 2010 në kuadër të hedhjes së mbeturinave është lënë në vete dhe se infrastruktura për këtë proces nuk ka ekzistuar. Duke investuar në infrastrukturë, duke angazhuar kompanitë e transportit të mbeturinave, ky problem vihet nën kontroll.

**Shtruarja e shtratit të lumit.** Me qëllim të urbanizimit të zonave rurale, të Graçanicës dhe Llapllasellës, një pjesë e shtratit të lumit Graçanka është shtruar. Shtruarja e tij me beton dhe gur nuk është treguar si një praktikë e mirë, sepse është parandaluar filtrimi natyror përmes eko-sistemit të lumit. Fatkeqësisht, për realizimin e këtij projekti nuk janë bërë studimet e ndikimit në eko-sistemin ekzistues dhe cilësinë e ujit. Problematika e qasjes joadekuate ndaj këtij lloji të investimit pa kërkime të detajuara dhe studimore nuk është e panjohur, madje është edhe praktikë.





# Zgjidhja

Përkundër të gjitha indikatorëve të mësipërm, të cilët ndikojnë në ndotjen e Graçankës, si shkak parësor mund të përmendet uji i cili pa një trajtim adekuat nga gropa e minierave derdhet në Graçankë. Edhe pse nuk janë bërë kërkimet e detajuara, kjo mund të shihet edhe në googlemaps. Rrjedhja e ujit të lumit Graçanka e ndryshon ngjyrën si një kameleon dhe atë nga burimi i tij deri te grykëderdhja. Seksioni që ndodhet drejtpërdrejt ndërmjet minierës dhe djerrinës, si dhe ngjyra e ujit në basenat e minierës, tregojnë për një anomali të parë, gjë që mund të shihet në foton e mëposhtëm të shkarkuar nga portali publik.

Cila është zgjidhja?

## Hapi i parë

OO Analiza e rregullave ligjore mbi përgjegjësitë e të gjithë akterëve në procesin e prodhimit, hedhjes dhe deponimit të mbetjeve industriale dhe kimike, si dhe Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, Mbrojtjen e Lumenjve dhe Rrjedhave Ujore, është shkalla e parë në kërkimin e zgjidhjes.



**O Foto 1:** Sedimentuesit dhe kompleksi i kullimit në minierën e Kishnicës, Trepçë

OO Analiza e cilësisë së ujit, përmbajtjes së tij, ndikimit në mjedisin jetësor, ndikimit në shëndetin publik, ndikimit në ujërat nëntokësore dhe eko-sistem, është një hap pa të cilin nuk mund të gjenden përgjegjësit për zinxhirin e ndotësve.

OO Diskutimet publike që i përfshijnë të gjitha instancat vendimmarrëse, profesionin dhe

popullsinë lokale janë gjithashtu një segment i rëndësishëm në rrugën drejt një mjedisi më cilësor.

OO Arritja e një komunikimi dhe bashkëpunimi shumë më të mirë me institucionet qendrore, pa të cilat zgjidhja e këtyre problemeve është punë sizife.

## Hapi i dytë

Për trajtimin e ujit përdoren këto procedura të pastrimit: procedura mekanike, biologjike dhe kimike.

OO Procedurat mekanike janë të bazuara në heqjen e papastërtisë fizike të ujit dhe në parimin e veprimit të forcave fizike (graviteti, presioni). Cila procedurë do të zbatohet varet nga karakteristikat e ujërave të zeza dhe shkalla e kërkuar e trajtimit. Metodot mekanike të trajtimit të ujit konsistojnë në heqjen e makro dhe mikro grimcave suspenduese nga uji me origjinë organike dhe inorganike. Për këtë qëllim përdoren:

- OO grilat dhe sitat,
- OO sedimentimi,
- OO flotimi,
- OO filtrimi,
- OO centrifugimi,
- OO kurthet e rërës,
- OO tërheqësit e vajit;

OO sedimentuesit parësorë dhe basenat e barazimit të rrjedhës. Në kuadër të këtyre impianteve përdoren edhe pajisjet për ajrimin e ujërave të zeza, me të cilat arrihet ndarja më e mirë e grimcave inerte, flotimi i yndyrave dhe vajrave, futja e një sasive të caktuar të oksigjenit në ujë, si dhe desorbimi i disa gazeve nga uji.

## Grilat dhe sitat

Falë grilave hiqen substancat e mëdha, të patretshme dhe lundruese nga ujërat e zeza me ndihmën e grilave. Roli i tyre është të mbrojnë pajisjet dhe gypat nga dëmtimet e bllokimet dhe ta lehtësojnë trajtimin e mëtejshëm të ujërave të zeza. Grilat e ndajnë kanalin e furnizimit dhe vendosen vertikalisht ose në një pjerrësi, zakonisht 40-70 °.

## Sedimentimi

Sedimentimi mund të jetë faza paraprake dhe e fundit e trajtimit të ujit. Përdorimi i grilave dhe sitave, si dhe kurtheve të rërës dhe tërheqësve të vajit mund të konsiderohet si një proces i sedimentimit me objekte të caktuara infrastrukturore të destinuara për këtë lloj të ndarjes së substancave. Objektet infrastrukturore janë sedimentuesit. Dimensionet e të gjitha llojeve të sedimentuesve varet nga: rrjedha e ujërave të zeza, koncentrimi i përbërësve të patretur, dendësia dhe përzjerja e ujit dhe sedimentit, kinetika e sedimentimit. Mungesa e sedimentuesve horizontal dhe radial është se rrjedha e ujit është e theksuar, gjë që shkakton rezistencë shtesë dhe parandalon sedimentimin, si dhe problemin e kullimit të llumit. Për këtë qëllim përdoren sedimentuesit vertikal.

Si shembull i praktikës së mirë, por edhe të rasteve të problematikës së ngjashme, është shembulli i Majdanpekut, basenit të minierës në Serbinë lindore. Në këtë punim është paraqitur koncentrimi mesatar vjetor i joneve të metaleve të rënda në ujërat e zeza të impiantit të filtrimit të minierës së bakrit të Majdanpekut. Në bazë të analizave kimike të mostrave të ujërave të zeza është konstatuar përmbajtja e ngritur e joneve të metaleve të rënda (Cu, Fe, Mn, Zn, Pb, Cd, etj.), të cilat i tejkalojnë vlerat e koncentrimit maksimal të lejuar të përcaktuar me rregulloren e Republikës së Serbisë.

Rezultatet e marra janë krahasuar me kufijtë e lejuar të koncentrimin të përcaktuar me Rregulloren e Punës e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Direktivën 98/83/EC e Bashkimit Evropian, si dhe me disa të dhëna të literaturës. Në fund të punimit është dhënë propozimi për zvogëlimin e koncentrimin të joneve të metaleve të rënda në ujërat e zeza të impiantit të filtrimit duke përdorur rrëshirën e shkëmbimit të joneve.

Ujërat e zeza industriale nuk mund të trajtohen me procesin konvencional të trajtimit të ujit, sepse përmbajnë jone metalike, si dhe komponime të tjera kimike që janë të biodegradueshme, gjë që ndikon në mënyrë destruktive mbi mikroorganizmat që janë aktiv në procesin e trajtimit natyror. Përmirësimi i cilësisë së ujërave të zeza të impiantit të filtrimit mund të realizohet duke përdorur adsorbentë të ndryshëm. Për adsorbim në lëngje përdoren jonitet, qymyri akrilik, xhel silic dhe zeolitet. Jonitet si adsorbente natyrore ose sintetike, me origjinë organike ose inorganike, mund të jenë: zeolitet, mineralet argjilore, rrëshirat e shkëmbimit të joneve, mineralet e aktivizuara, etj.

Praktikisht, ato janë të patretshëm në ujë ose tretës të tjerë. Ato ndahen në anione dhe katione, në varësi të strukturës së molekulave dhe reaksioneve me jonet që gjenden në tretësirë dhe që adsorbohen. Për largimin e metaleve të rënda nga ujërat e zeza përdoren llojet e ndryshme të shkëmbyesve të joneve katione, siç janë: Amberlite IR-120, Dowex 50, Duolite C-20, Lewatit S-100, etj.

Në mënyrë që të mos vie deri tek humbjet e mëdha të xehes përmes ujërave të zeza, propozohet plotësimi i procesit të trajtimit të ujërave të zeza. Preferohet që të bëhet një kafaz i rrjetit me vëllim adekuat, varësisht nga koncentrimi mesatar i joneve të tepërta të metaleve të rënda dhe cilësia e rrëshirës së shkëmbimit të joneve, në të cilin gjendet rrëshira e shkëmbimit të joneve. Kafazi i rrjetit do të vendosej në nivelin e ujërave të zeza në sedimentuesit në të cilin do të derdhej uji i

tejmëshur nga trashësuesi. Në këtë mënyrë do të zvogëlohet koncentrimi i joneve të zinkut, hekurit dhe plumbit në ujërat e zeza të impiantit të filtrimit. Pas një kohe të caktuar përdorimi, rrëshira e shkëmbimit të joneve është e mbingopur me jone të metaleve të rënda të lidhur. Procesi i desorbimit të joneve të metaleve të rënda nga rrëshira e shkëmbimit të joneve përcaktohet nga prodhuesi, gjë që në këtë rast duhet të bëhet në bashkëpunim me kompaninë Trepça. Një nga mënyrat e trajtimit të rrjetit me rrëshirë jonike është rigjenerimi i rrëshirës me një tretës të acidit sulfurik.

## Hapi i tretë

Si shtesë e përmirësimit të cilësisë së ujit duhet të shqyrtohen të gjitha zgjidhjet e ofruara deri më tani, ndër të cilat është edhe zhvendosja e mbetjeve minerare dhe pyllëzimi i djerrinës me bimë adekuate që i thithin ndotësit (metalet e lëngëta dhe komponimet toksike) nga toka, për të cilat ekzistojnë studimet hulumtuese-shkencore dhe të fizibilitetit nga ekspertët e shquar të fushës së shëndetit, mjedisit, teknologjisë.



# Rekomandimet

Rekomandimi për të gjithë personat fizik dhe juridik është që fushata shëndetësore kurrë nuk duhet të ndalet, ndërsa ajrin, ujin dhe mjedisin duhet të ndajmë me të njëjtën përgjegjësi dhe pasoja.

Rekomandimet konkrete për akterët e përfshirë në vendimmarrje janë:

- Qasje e përgjegjshme për vendosjen e problemeve prioritare dhe zgjidhjen e tyre me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe ruajtjes së mjedisit
- Analiza dhe zbatimi i përgjegjshëm i rregullave ligjore dhe zbatimi i politikave ndëshkuese, duke përfshirë të gjitha instancat dhe akterët në procesin e realizimit dhe zbatimit të zgjidhjes së problemeve
- Analiza adekuate profesionale dhe koncize e problemit
- Ndërlidhja institucionale, vendosja e komunikimit ndërmjet akterëve lokal, qendror dhe ndërkombëtar me qëllim të mbrojtjes e të drejtave themelore të njeriut
- Rritja e vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit, por me një shembull konkret të praktikës së mirë në të cilën institucionet do të tregojnë se i qasen kësaj teme me shumë përgjegjësi.
- Rritja e financimit buxhetor për fushën e hulumtimit, analizës, kryerjes së studimeve të fizibilitetit, projekteve dhe zbatimit të tyre në fushën e mbrojtjes së mjedisit, që nënkupton uljen e ndotjes dhe trajtimin adekuat të ujërave të zeza.





# Fjala përmbyllëse

Në konkluzionin e këtij citati duhet të theksohet se zgjidhjet e problemeve mjedisore janë së pari në mendjet e udhëheqësve të akterëve lokal, qendror, ndërkombëtar, madje edhe joqeveritarë. Ekzistenca e listave prioritare për eliminimin e ndotësve duhet të jetë imperative për këdo që ka synime të sinqerta në ruajtjen e shëndetit të komunitetit dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe të shëndetshëm.

Ky qëllim mund të arrihet përmes reagimit në kohë, kodeve shtesë buxhetore dhe mjeteve për rehabilitim dhe reagim, angazhimit shtesë të stafit profesional për testim, projektim, hulumtim, respektimit të rregullave ligjore dhe politikës ndëshkuese, ku nuk ka të favorizuar apo të privilegjuar.



OPEN

**Iniciativa OPEN është përkrahur nga:**



**KFOS**

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo